



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:273113

Datë: 04.06.2024

Numri i dokumentit: 05780150

KPPP.nr. 2108/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Agro Fitimi” D.P.T, me numër unik identifikues 810241745, me adresë në Gjakovë, rr. “Konferenca e Bujanit”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Blerim Xheravina, avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Mastering Company” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811499492, me seli në Gjakovë, rr. “Bardhyl Qaushi”, nr. 59, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Leutrim Syla, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 881/23 të datës 10.11.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Gëzim Gjoshi me seli të zyrës në Gjakovë, jashtë seancës, me datë 04.06.2024, merr këtë.

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Mastering Company” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 881/23 i datës 10.11.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Gëzim Gjoshi, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Agro Fitimi” D.P.T, me datë 10.11.2023 ka lëshuar Urdhrin përmbartimor P.nr. 881/23 me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumenteve: Faturës nr. 23-SHV01-010-17, e datës 24.02.2023; Faturës nr.23-SHV01-003-15, e datës 10.03.2023; Faturës nr. 23-SHV01-010-48, e datës 15.04.2023; Faturës nr. 23-SHV01-010-127, e datës 09.10.2023; Faturës nr. 23-SHV01-001-309, e datës 13.10.2023 dhe Faturës nr. 23-SHV01-003-85, e datës 01.11.2023, duke urdhëruar debitorin që në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e dorëzimit të urdhrit, t’ia paguaj kreditorit borxhin sipas faturave të lartcekura në shumë prej EUR 65,243.41, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data kur kredia është

bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar urdhrin për përbarim me arsyetimin se nga faturat si në propozimin për përbarim kreditori ka dërguar material ndërtimor në shumë totale prej 17,535.75 €, ndërsa me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm ka lëshuar fatura, mirëpo nuk e ka dërguar materialin ndërtimor tek debitori. Më tej, ka theksuar se ka realizuar pagesa duke paguar më shumë sesa ka pranuar material ndërtimor, ku vërtetohet përmes listës së transaksioneve bankare të realizuara nga data 09.02.2023 deri më datë 28.07.2023, duke paguar rreth 42.000.00 € në emër të faturave. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të pranojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të anulohet, si dhe të obligohet kreditori që të paguajë shpenzimet e procedurës përbarimor për prapësimin e ushtruar në vlerë prej EUR 156.00.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetim se është lejuar urdhri përbarimor në bazë të faturave si dokumente të besueshme, të cilat janë paraqitur në origjinal dhe janë pranuar, nënshkruar dhe vulosur nga debitori. Ka shtuar se nuk qëndron pretendimi i debitorit sa i përket asaj që nuk i është dorëzuar malli, pasi që edhe nga nënshkrimi i faturave vërtetohet se i njëjti ka pranuar mallin me rastin e pranimit të faturave. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet*

në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se urdhri përbarimor P.nr. 881/23 i datës 10.11.2023 bazohet në faturat nr. 23-SHV01-010-17, e datës 24.02.2023; nr.23-SHV01-003-15, e datës 10.03.2023; nr. 23-SHV01-010-48, e datës 15.04.2023; nr. 23-SHV01-010-127, e datës 09.10.2023; nr. 23-SHV01-001-309, e datës 13.10.2023 dhe faturës nr. 23-SHV01-003-85, e datës 01.11.2023 nr. 21-SHV01-001-20 të datës 08.04.2021 të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara me nenin 29, par.3 të LPP-së, kjo pasi që në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara qartë mallrat të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara edhe në nenin 37 të LPP, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, dhe janë është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula debitorit e pasqyruar tek pranuesi i secilës faturë.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se borxhi i kërkuar me propozimin për përbarim nuk është real pasi që debitori ka bërë pagesa të kohë pas kohshme në vlerë totale prej 42,000.00 EUR, por që gjykata, nga kartela e blerësit e datës 08.11.2023 e paraqitur nga kreditori në propozimin për përbarim, vërtetoi faktin se pagesat të cilat debitori i është referuar në prapësim, janë evidentuar dhe zbritur nga totali i borxhit sipas faturave objekt i këtij përbarimi, andaj vlera e kërkuar në propozimin për përbarim, paraqet vlerën e papaguar nga debitori për kreditorin.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se kërkesat nga faturat objekt i këtij përbarimi nuk janë bërë të arritshme, kjo pasi që kreditori nuk i ka bashkëngjitur flete dërgesat për pranimin e mallit për secilën faturë, por që me vet pranimin e faturave kontestuese të cilat kanë paraparë edhe afatin për pagesë, dhe atë pa asnjë kundërshtim, debitori është pajtuar me detyrimin që derivon nga të njëjtat dhe afatin kohor për përmbushjen e tyre.

Gjykata, vlerësoi pretendimet edhe pretendimet tjera të debitorit të ngritura në prapësim, por gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë ashtu siç kërkohet me nenin 69, par.4 të LPP-së për vërtetimin e një prej shkaqeve taksative mbi bazën e të cilave mund të bazohet prapësimi nga

neni 71 i LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me refuzimin e prapësimit të debitorit, Gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2108/23, datë 04.06.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE. Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.